



## KOMUNIKATË

**4.11.2009**

Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, sot më mesditë e ka vizituar shefi i ICO-së z. Pieter Feith. Z. Feith, është pritur nga anëtarët e KQZ-së. Kryetarja e KQZ-së znj. Nesrin Lushta, i ka dëshiruar mirëseardhje z. Feith, duke e njoftuar me përgatitjet e fundit që po i bënë KQZ për zgjedhjet Lokale të 15 nëntorit. “KQZ është duke i bërë përgatitjet e fundit. Për ne është shumë e rëndësishme të arrijmë t’i realizojmë të gjitha planet që kemi. Ne i falenderojm të gjitha institucionet lokale dhe ndërkombëtare për ndihmën që po na japin, dhe jemi mirënjohës për këtë”, ka thënë znj. Lushta në takim.

Shefi i ICO-së z. Pieter Feith, ka konfirmuar mbështetjen e institucionit që ai udhëheq për KQZ-në në përgatitjen dhe mbajtjen e zgjedhjeve. “Jemi shumë të lumtur që e vizitojmë KQZ-në. Siq e kemi parë, KQZ ka treguar mjaft progres, ka realizuar me sukses afatet e planeve të veta dhe ne dëshirojmë të sigurohemi dhe shpresojmë që zgjedhjet të kalojnë sa më mirë. Këto janë zgjedhjet e para që mbahen në mënyrë të pavarur dhe janë shumë të rëndësishme. Unë dëshiroj që t’ju tregoj se do të keni përkrahjen e fort duke përfshirë institucionet ndërkombëtare si Unionin Evropian por edhe partnerët që kontribuojnë dhe që ju mbështesin në punën tuaj. Ne ju dëshirojmë gjithë të mirat në përgatitjen e zgjedhjeve”, është shprehur z. Pieter Feith.

Duke e falënderuar për vizitën, z. Feith e kanë përshëndetur edhe disa anëtarë të KQZ-së. Pastaj, në shoqërim të kryetares Nesrin Lushta, z. Feith ka vizituar ambientet e KQZ-së dhe është njoftuar me punën që bëhet këtu.